



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3439/5 prot.

Datë 10.12.2025

V E N D I M
Nr. 1830/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.12.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 3439/2025 prot., datë 02.12.2025 i operatorit ekonomik “Xpert Systems” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt: “Blerje pajisje GPS” për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR”, me fond limit 5,567,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Xpert Systems” SHPK, me NIPT L51511023L dhe adresë: Njësia Bashkiake nr. 10, rruga Mihal Duri , nr. 3, kati i III, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.10.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt: “Blerje pajisje GPS” për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR”, me fond limit 5,567,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 09.09.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. Xpert Systems	3,885,500	lekë	Skualifikuar
2. Alb-Matrix Group	4,176,010	lekë	Kualifikuar
3. LAND & CO	4,180,000	lekë	Skualifikuar
4. GeoTech	4,850,700	lekë	Skualifikuar
5. A-T-D” Albanian Technology Distribution	5,567,000	lekë	Skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 21.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 27.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6131 dhe nr.3439/2025 prot, datë 02.12.2025 i operatorit ekonomik “Xpert Systems” SHPK, i cili lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vleresimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Xpert Systems” SHPK , nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3439/1, datë 03.12.2025.

II.7. Në datën 09.12.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues, “Xpert Systems” SHPK, me shkresën nr.89 prot., datë 09.12.2025, me objekt “Kërkesë”, protokolluar me tonën me nr.3439/2 prot., datë 09.12.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt: “Blerje pajisje GPS” për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR”, me fond limit 5,567,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, duke u shprehur se:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa e paraqitur nga shoqëria jonë Xpert Systems sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur - e Thjeshtuar", me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt "Blerje pajisje GPS për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR", me fond limit 5.567.000 (pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor "Operatori i Blerjeve të Perqendruara".

Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së, deklarojmë tërheqjen nga ankesa e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe kërkojmë heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur, si një e drejtë e parashikuar për operatorin ekonomik, në kushtet kur ndjekja e procedurës së ankimimit, nuk përbën më interes për ne. Për shkak të angazhimeve të tjera tonat, tërhiqemi prej ankesës, për të shmangur kështu të qenit pengesë për zhvillimin e objektit të procedurës për Autoritetin Kontraktor”.

II.8 Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, “Xpert Systems” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt: “Blerje pajisje GPS” për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR”, me fond limit 5,567,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1 Në datën 09.12.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues, “Xpert Systems” SHPK, me shkresën nr.89 prot., datë 09.12.2025, me objekt “Kërkesë”, protokolluar me tonën me nr.3439/2 prot., datë 09.12.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt: “Blerje pajisje GPS” për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR”, me fond limit 5,567,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, duke u shprehur se:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa e paraqitur nga shoqëria jonë Xpert Systems sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur - e Thjeshtuar", me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt "Blerje pajisje GPS për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR", me fond limit 5.567.000 (pesë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor "Operatori i Blerjeve te Perqendruara".

Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së, deklarojmë tërheqjen nga ankesa e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe kërkojmë heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur, si një e drejtë e parashikuar për operatorin ekonomik, në kushtet kur ndjekja e procedurës së ankimimit, nuk përbën më interes për ne. Për shkak të angazhimeve të tjera tonat, tërhiqemi prej ankesës, për të shmangur kështu të qenit pengesë për zhvillimin e objektit të procedures për Autoritetin Kontraktor”.

III.1.2. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 3439/2025 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, “Xpert Systems” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-66994-10-28-2025, me objekt: “Blerje pajisje GPS” për autoritetin kontraktor përfitues AZHBR”, me fond limit 5,567,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, “Xpert Systems” SHPK .
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

